



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.2864/4

Datë 26.01.2023

**V E N D I M**

**Nr. 58/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.01.2023 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Anulimin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, me nr REF-27371-05-04-2022 me objekt “*Hartim projekti rehabilitimi rrugës “Kasem Durrësi”* me fond limit 2,472,686.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 20-05-2022 nga autoriteti kontraktor Bashkia Durrës.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “STUDIO SERVICES ‘D-S’ SHPK  
Lagjja 3, Rruga Egnatia dhe Rruga Ramazan Jella, Pallati 1125,  
Kati i parë

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Durrës  
Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nen kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 10-05-2022, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Shërbim konsulence*”, me nr. REF-27371-05-04-2022 me objekt “Hartim projekti rehabilitimi rrugës “Kasem Durrësi” me fond limit 2,472,686.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 20-05-2022 nga autoriteti kontraktor Bashkia Durrës.

II.2. Në datën 18.08.2022, autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e dytë të procedurës së prokurimit.

II.5 Nga verifikimet është publikuar Njoftim Fituesi Paraprak ne SPE në datë 19.12.2022

II.6 Në datën 25.12.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është paraqitur në mënyrë elektronike në Sistemin e Ankesave Elektronike ankesa me nr. A/2022/2787, protokolluar me nr. 2864/2022 datë 27.12.2022 e operatorit ekonomik STUDIO SERVICES D– S” SHPK për procedurën e prokurimit Shërbim konsulence”, me nr. REF-27371-05-04-2022 me objekt

“Hartim projekti rehabilitimi rrugës “Kasem Durrësi” me fond limit 2,472,686.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 20-05-2022 nga autoriteti kontraktor Bashkia Durrës.

II.7 Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 2864/2 prot., datë 27.12.2022 janë publikuar pretendimet që operatori ekonomik ankimues “Studio Services K-Sa” SHPK” kundërshton me anë të ankesës me nr. 2864 protokolli, datë 25.12.2022.

II.8 Me shkresën nr. 186/3 prot, datë 12.01.2023 protokolluar me tonën me nr. 2864/3 prot datë 16.01.2023 , autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “*Studio Services D-S*” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton, se autoriteti kontraktor e ka vendosur mospranimin e saj.

II.9 Nga verifikimet e kryera, rezulton, se nuk janë paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik argumente nga subjekte të interesuara lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*Studio Services D-S*” SHPK sipas parashikimeve të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

#### **Arsyeton**

III.1..Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “STUDIO SERVICES D-S” SHPK, se:[...] *“gjithashtu kërkojmë të vlerësohet a janë dorëzuar dokumentacioni sipas dst në fazën e parë të prokurimit dhe konkretisht dokumentacioni sipas pikës 2.3 pika b specifikisht. apo nga operatorët ekonomik është paraqitur vetëm vetdeklarimi. sepse në një procedurë prokurimi doli që duhet të paraqiteshin dokumentacioni si licenca projektimit.[..], Komisioni Prokurimit Publik vëren se..*

III.1.1. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se autoriteti kontraktor me hapat procedural ndodhet në fazën e Publikimit të njoftimit të fituesit paraprak.

III.1.2 Në nenin 50 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, është parashikuar se:

Neni 50; **Shërbim konsulence**

1. Shërbim konsulence është një procedurë prokurimi me faza, e cila shërben për prokurimin e kontratave publike për shërbime të një natyre intelektuale dhe/ose këshilluese.

2. Në procedurat mbi kufirin e lartë monetar, çdo operator ekonomik mund të dorëzojë një kërkesë për pjesëmarrje në përgjigje të njoftimit që përmban informacionin e përcaktuar në rregullat e prokurimit publik.

Afati kohor minimal për marrjen e kërkesave për pjesëmarrje është jo më pak se 30 ditë nga data në të cilën është publikuar njoftimi i kontratës ose ftesa për shprehje interesi.

3. Në fazën e dytë, ofertë mund të paraqesin vetëm kandidatët e përzgjedhur nga autoriteti kontraktor.

Afati minimal për pranimin e ofertave është jo më pak se 30 ditë, nga data në të cilën është publikuar ftesa për ofertë.

4. Në procedurat mbi kufirin e lartë monetar, autoriteti kontraktor mund të shkurtojë me 5 ditë afatin kohor për marrjen e kërkesave ose ofertave, të përcaktuar në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, në rast se procedura e prokurimit zhvillohet me mjete elektronike.

5. Për procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, afati për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje ose ofertave është jo më pak se 20 ditë nga publikimi i njoftimit të kontratës ose ftesës për ofertë dhe në rast se procedura e prokurimit zhvillohet me mjete elektronike, ky afat mund të shkurtohet me 5 ditë.

6. Për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, afati për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje ose ofertave është jo më pak se 10 ditë nga publikimi i njoftimit të kontratës ose ftesës për ofertë.

7. Procedurat e hollësishme të zhvillimit të kësaj procedure prokurimi parashikohen në rregullat e prokurimit publik.

III.1.3. Në piken 11 gërma të nenit 54 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

11. Hapat e procedurës së shërbimit të konsulencës janë:

- a) Në fazën e parë të kualifikimit, autoriteti/enti kontraktor përgatit preventivin e kostos dhe buxhetit, të cilat janë pjesë e njoftimit të kontratës. Preventivi i kostos bazohet në vlerësimin që autoriteti ose enti kontraktor u bën burimeve që i nevojiten për të përmbushur detyrën: kostoja për stafin, mbështetja logjistike dhe inputi fizik.

Kostot duhet të ndahen në dy kategori kryesore:

- i. tarifat (ose shpërblimi);
- ii. rimbursimet.

- b) Në fazën e dytë, kërkesa për propozime, që u dërgohet kandidatëve të përcaktuar në listën e shkurtër, përfshin:

- i. ftesat, ku deklarohen qëllimi i autoritetit ose entit kontraktor për të nënshkruar kontratën për shërbimet e konsulencës, burimi i fondeve, hollësi të tjera për kandidatin, adresa, data, ora e përcaktuar për dorëzimin e propozimeve;
- ii. udhëzimet për ofertuesit, ku jepet i gjithë informacioni i nevojshëm që do t'i ndihmonte ofertuesit për përgatitjen e propozimeve, si dhe informacione për procesin e vlerësimit, metodologjinë, kriteret e vlerësimit e faktorët e rëndësishëm përkatëse të tyre dhe pikët minimale për cilësinë;
- iii. periudhën e vlefshmërisë së propozimit;
- iv. kushtet e projektkontratës, që do të prokurohet;
- v. afatet kohore për dorëzimin e propozimeve;
- vi. formularin e sigurimit të ofertës sipas përcaktimit në LPP.

Nga marrja e kërkesës për propozim deri në afatin e fundit për dorëzimin e propozimeve, ofertuesit mund të kërkojnë sqarime për informacionet e dhëna në kërkesën për propozime. Autoriteti/enti kontraktor jep sqarimet përkatëse dhe ua dërgon të gjithë kandidatëve të përcaktuar në listën e shkurtër. Nëse është e nevojshme, autoriteti/enti kontraktor zgjat afatet kohore për dorëzimin e propozimeve, duke argumentuar dhe dokumentuar nevojën për këtë zgjatje.

- c) Propozimet teknike dhe ekonomike duhet të dorëzohen në të njëjtën kohë, të ndara nga njëra tjetra. Pas mbarimit të afateve kohore për dorëzim, nuk duhet të pranohet asnjë ndryshim i propozimeve teknike ose ekonomike. Propozimet teknike, hapen menjëherë pas mbarimit të afatit për dorëzimin e propozimeve, ndërkohë që propozimet ekonomike mbeten të pahapura. Çdo propozim që merret pas mbarimit të afatit, kthehet i pahapur.
- ç) Vlerësimi i propozimeve teknike kryhet duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:
  - i. përvojën e konsulentit;
  - ii. cilësinë e metodologjisë së propozuar;
  - iii. kualifikimet e stafit kryesor të propozuar;
  - iv. transferimin e njohurive, nëse kërkohet. Nëse nuk kërkohet, pikët maksimale të parashikuara për vlerësimin e këtij kriteri duhet t'i shtohen kriterit “kualifikimet e stafit kryesor të propozuar”.

Çdo kriter vlerësohet në një shkallë nga 1 deri në 100 dhe më tej, pesha e tyre kthehet në pikë përkatëse. Minimumi i pikëve të propozimit teknik për të vazhduar me vlerësimin e propozimit ekonomik është 70 pikë. Formula që zbatohet në këtë rast parashikohet në dokumentet standarde të tenderit.

Vlerësimi i propozimeve teknike kryhet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga afati i përfundimtar i përcaktuar për hapjen e tyre.

*Secili prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave duhet të shpjegojë në detaje vlerësimin e tij.*

*Në çdo rast, ky proces dokumentohet.*

*Autoriteti/enti kontraktor vë në dijeni ofertuesit që kanë dorëzuar propozime për çdo vlerësim teknik me pikë për secilin konsulent. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor njofton ata konsulentë, propozimet e të cilëve, nuk kanë arritur të fitojnë pikët minimale ose që janë vlerësuar se nuk i plotësojnë kërkesat për propozim, dhe nuk vijon me hapjen e propozimeve të tyre ekonomike.*

*d) Në përfundim të afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor njofton konsulentët që kanë realizuar pikët minimale kualifikuese për datën, orën dhe adresën për hapjen e propozimeve ekonomike.*

*Propozimet ekonomike hapen publikisht, në prani të përfaqësuesve të konsulentëve që marrin pjesë, vetë ose përmes telekonferencës apo mjeteve të tjera elektronike, nëse është e mundur. Emri i ofertuesit, pikët e vlerësimit teknik dhe çmimet e propozuara lexohen me zë të lartë dhe regjistrohen gjatë hapjes së propozimeve ekonomike. Për vlerësimin në çmim përfshihen të gjitha pagesat e konsulentëve, si dhe shpenzimet e tjera si p.sh., shpenzimet për udhëtime, përkthimin, printimin e raporteve ose shpenzimet sekretariale. Propozimit me çmimin më të ulët i jepet vlerësimi financiar prej 100 pikësh, ndërsa propozimeve të tjera u jepen vlerësime financiare ku çmimet e tyre janë në përpjesëtim me çmimin më të ulët.*

*dh) Vlerësimi përfundimtar total në pikë realizohet duke mbledhur pikët për cilësinë dhe koston. Pikët për “koston” caktohen duke marrë parasysh kompleksitetin e objektit të kontratës së prokurimit, si dhe rëndësinë përkatëse të cilësisë.*

*e) Në vijim, autoriteti/enti kontraktor identifikon ofertën më të mirë dhe shpall ofertuesin fitues. Në përfundim të afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor fton ofertuesin fitues për të nënshkruar kontratën<sup>1</sup>.*

*Oferta ekonomike nuk duhet të ndryshohet në asnjë rast.*

*ë) Kur fituesi nuk arrin të nënshkruajë kontratën ose nuk arrin të bëjë sigurimin e kontratës, autoriteti/enti kontraktor fton për lidhjen e kontratës ofertuesin vijues në klasifikimin e ofertuesve;*

*f) Në rast se kontrata lidhet me një bashkim operatorësh, të gjithë anëtarët e bashkimit të operatorëve duhet të nënshkruajnë kontratën dhe të jenë, individualisht dhe bashkërisht, përgjegjës për detyrën.*

*g)*

*III.1.4. Në nenin 97, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, është parashikuar se:*

*“1. Menjëherë, por jo më vonë se 5 ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave, autoriteti kontraktor publikon në sistemin e prokurimit elektronik njoftimin e fituesit. Me*

*publikimin e njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik, operatorëve ekonomikë i lind e drejta e ankimit sipas parashikimeve të nenit 109 të këtij ligji.*

*2. Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në formë shkresore, autoriteti kontraktor publikon njoftimin e fituesit në Buletinin e Njoftimeve Publike. Me publikimin e njoftimit të fituesit në Buletinin e Njoftimeve Publike, operatorëve ekonomikë iu lind e drejta e ankimit sipas parashikimeve të nenit 109 të këtij ligji.”*

III.1.5 Në nenin 110, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, është parashikuar se:

*“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit.*

*Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.*

*3. Në procedurat e prokurimit me faza mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit për këtë vendim.*

*Në procedurat e prokurimit me faza nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”*

III.1.6 Në nenin 94 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

*1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.*

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje pikat 1, 2 dhe 3 të nenit 50 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku përcaktohet: “1. Shërbim konsulence është një procedurë prokurimi me faza, e cila shërben për prokurimin e kontratave publike për shërbime të një natyre intelektuale dhe/ose këshilluese. 2. Në procedurat mbi kufirin e lartë monetar, çdo operator ekonomik mund të dorëzojë një kërkesë për pjesëmarrje në përgjigje të njoftimit që përmban informacionin e përcaktuar në rregullat e prokurimit publik. Afati kohor minimal për marrjen e kërkesave për pjesëmarrje është jo më pak se 30 ditë nga data në të cilën është publikuar njoftimi i kontratës ose ftesa për shprehje interesi. 3. Në fazën e dytë, ofertë mund të paraqesin vetëm kandidatët e përzgjedhur nga autoriteti kontraktor. Afati minimal për pranimin e ofertave është jo më pak se 30 ditë, nga data në të cilën është publikuar ftesa për ofertë.” Ndërsa në formularin e njoftimit të fituesit, të publikuar në buletin nr. 12, datë 31.01.2022 të Agjencisë së Prokurimit Publik, i cili është formular standard i miratuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe është i përfshirë në dokumentet standarde të tenderit, përcaktohet: “Me marrjen/publikimin e

*këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.*

III.1.8. Komisioni gjykon të ndalet dhe të analizojë, përcaktimet ligjore në fuqi për prokurimin publik lidhur me ankimet në procedurat e prokurimit, si dhe afatet për paraqitjen e tyre. Komisioni sjell në vëmendje, se legjislacioni në fuqi për prokurimin publik parashikon kryerjen e procedurave të prokurimit me një fazë, ku ofertuesit paraqesin njëkohësisht dokumentacionin e nevojshëm (për të vërtetuar se përmbushin kriteret e kualifikimit) dhe ofertën ekonomike, për të cilat autoriteti kontraktor kryen vetëm një proces vlerësimi e më pas shpall fituesin e kontratës ose me disa faza ku paraprakisht operatorët ekonomikë të interesuar, në cilësinë e kandidatit, paraqesin kërkesat për pjesëmarrje dhe dokumentacionin e nevojshëm për të vërtetuar se përmbushin kriteret e kualifikimit dhe në rast se kualifikohen/përzgjidhen, ftohen nga autoriteti kontraktor për të paraqitur ofertat teknike dhe ekonomike në varësi të procedurës konkrete. Në procedurat e prokurimit me disa faza, autoriteti kontraktor është i detyruar që për çdo fazë të bëjë vlerësimin përkatës, ku në fazën e parë vlerëson kërkesat për pjesëmarrje dhe dokumentacionin e nevojshëm (për të vërtetuar se kandidatët përmbushin kriteret e kualifikimit) e më pas në fazat e tjera vlerëson ofertat teknike dhe ekonomike vetëm të operatorëve ekonomikë të cilët janë ftuar (pasi janë kualifikuar) nga autoriteti kontraktor për të paraqitur ofertë. Gjithashtu, Komisioni vëren, se ligjvënësi ka parashikuar mundësinë e ankimit në disa raste dhe momente procedurale të procedurës së prokurimit, ku ndër të tjera, dy prej tyre janë ankimi për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar sipas pikës 2 të nenit 110 të LPP-së dhe ankimi për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit në procedurat me faza sipas pikës 3 të nenit 110. Sa më sipër, Komisioni gjykon se ligjvënësi ka bërë një ndarje lidhur me momentin procedural të nisjes së afateve të ankimit vetëm mbi vendimmarrjen e autoritetit kontraktor për kualifikimin përzgjedhjen e kandidatëve në fazën e parë të procedurës së prokurimit, pasi vetëm në këtë rast operatorët ekonomikë mund të ankohen për këtë vendim brenda 10 ditëve nga momenti i marrjes dijeni për të në rastet e kontratave me vlerë mbi kufirin e lartë monetar, si dhe 7 ditëve nga momenti i marrjes dijeni për të në rastet e kontratave me vlerë nën kufirin e lartë monetar.

Në rastin konkret, Komisioni vëren se operatorit ekonomik “Studio Srvices D-S” SHPK ka paraqitur ankesë duke kundërshtuar vlerësimin në lidhje me dokumentacionin e operatorëve ekonomikë në lidhje me përmbushjen e kriterit të përcaktuar nga autoriteti përkatësisht pikës 2.3 pika b, dhe jo të pikëve të propozimeve teknike të paraqitura, pasi keto pretendime të operatorit ekonomik ankimmues janë në fazën e parë të procedurës së prokurimit. Sa më sipër, Komisioni gjykon, se jemi në kushtet ankimit lidhur me fazën e parë të procedurës dhe jo në këtë moment procedural ku ndodhemi.

Komisioni sqaron, se ligjvënësi e ka ndarë qartë vlerësimin lidhur me kërkesat për pjesëmarrje dhe vlerësimin e ofertave, sikurse ka ndarë statusin e kandidatit në fazën e parë të procedurës nga statusi i ofertuesit në fazën e dytë të procedurës.

Sa më sipër, bazuar në përcaktimet e sipërcituara, si dhe bazuar në parashikimet ligjore në fuqi për prokurimin publik, Komisioni gjykon, se në rastin konkret, nga përlllogaritja e afatit për të



paraqitur ankesë në lidhje me permbushjen nga ana e operatorëve të tjerë për kriteret e kualifikimit, janë në fazën e parë të procedurës së prokurimit “Shërbim Kosulence”, dhe jo në fazën e dytë.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Studio Services D-S” SHPK nuk merren në shqyrtim.

III.2 Për sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankimues “Studio Services D-S” SHPK në lidhje me pretendimet e tjera të parashtruara në ankesë;

*S’del llogaria me pikët e DST, se ankuesi del që ka marrë 00.60 pikë, po si po shkojnë gjerat me AK dhe KPP-ne del se vendosin si të na vijë për mbarë tu pa duke bërë rrugës.*

*Theksojmë se rruga Kasem Durrsi dhe rruga A.Goga janë paralel me njera tjetren dhe se detyra e projektimit të tyre ka të njejtin parim me rrugën A.Goga nga muzeumi deri tek sheshi liria që është realizuar tanimë. Por mesa duket Autoritetit Kontraktor Bashkia Durres edhe pse pjesë e stafit të shoqërisë Ankuese janë dy nga inxhinieret që kanë kontribuar me shume se 10 vjet në Bashkinë Durres, hipokrizia nuk ka fund lidhur me vlerësimin e moseksperiences se ish stafit të tyre dhe metodologjis që ato kanë paraqitur edhe pse janë hartues të detyrave të projektimit dhe projektve ekzistuese të të njejtin parim. Gjithashtu theksojmë se ankuesi ka kërkuar informacion lidhur me dokumentacionin e paraqitur nga Operatorët e tjerë ekonomikë dhe ky informacion nuk i është dhënë ankuesit që ky i fundit të paraqes argumentet e tij ligjor mbi fakte lidhur me vlerësimin e ofertave të operatorëve të tjerë ekonomikë. Në këto kushte ankuesi kërkon vlerësimin e ofertave dhe të dokumentacionit Teknik dhe ekonomik të operatorve ekonomikë të kualifikuar si në fazën e parë paraqitja e kërkesës së interesit dhe të fazës së dytë. Kjo me arsyetimin se ka element të pavlerfshmërisë së kontratës" procedurës së prokurimit.*

*Lidhur me vlerfshmërinë e kontratës, ne kërkojmë të shpallet e pavlefshme procedura, pasi ajo përmban mangësi të theksuara në dokumentet e tenderit, si psh: Kriteri vlerësimit të pikëzimit për propozimin ekonomik?*

*Nuk është e qartë në pikën 2.3pika b nëse dokumentacioni plotësohet nëpërmjet vetdeklarimit apo duhet të paraqitet ky dokument" licenca projektimit?*

III.2.1 Komisioni sjell në vëmendje, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrtton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitetit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshme të ankesës”, ku ndër të tjera janë faktet dhe provat në të cilat bazohet ankesa” .

III.2.2. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është në drejtë të operatorëve ekonomikë të paraqesin pretendime mbi kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertës së operatorëve të tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke justifikuar kështu interesin e tyre të ligjshëm, por ndërkohë, operatorët ekonomikë nuk mund të

parashitrojnë pretendime a-priori pa argumentuar apo specifikuar se në cilat kritere specifikime apo shkëlqe procedurale mbështet ankesën e tij, duke mos dhënë asnjë provë apo argument se ku mbështet pretendimet e tij qoftë kjo dhe për anulimin e procedurës. Vetë Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar në nenin 82 pika 1 të tij se *“Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

Një ndër parimet kryesore të së drejtës është ai, se *“onus probandi incumbit actori”* se barra e provës bie mbi ankuesin. Gjithashtu, KPP gjykon, se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar të gjithë elementet procedurale, përmes të cilave garantohet e drejta e informimit të operatorëve ekonomikë në kuadër të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik. Konkretisht, neni 81 i ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 *“Për prokurimin publik”* të ndryshuar parashikon se: *“1. Informacioni dhe dokumentacioni i administruar sipas nenit 99 të këtij ligji, i vihet në dispozicion çdo personi të interesuar, palë në proces, me kërkesë të tij, pasi ka përfunduar klasifikimi i ofertave.*

*Autoriteti ose enti kontraktor është i detyruar të vërë në dispozicion informacionin brenda 5 ditëve nga data e marrjes së kërkesës.”*, ndërkohë po në nenin 81 pika 3 të tij parashikohet se *“3. Pa cenuar detyrimet që rrjedhin nga ky nen, autoritetet ose entet kontraktore mund të mos bëjnë publike disa nga informacionet e parashikuara në pikat 1 e 2 të këtij neni, nëse një gjë e tillë vjen në kundërshtim me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave ose cenon interesin publik apo interesat ligjore dhe ekonomike të palëve, ose pengon konkurrencën e drejtë. Nëse disa pjesë të ofertës së operatorëve ekonomikë deklarohen si konfidenciale, atëherë këto dokumente nuk do të vihen në dispozicion të kërkuësve.*

III.2.3 Sa më sipër, KPP gjykon, se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimesi duhet të kishte shoqëruar pretendimin e tij me prova, indicje dhe argumente ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej ky pretendim. Vlen të ritheksojmë, se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 90 të LPP dhe nenit 103 të VKM nr.285/2020, datë 23.12.2020 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e autoritetit kontraktor, por ligjëvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik.

III.2.4 Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkëlqen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij jo ta shprehë atë në mënyrë të pargumentuar. Theksojmë, se është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërbushje kriteri/kriteresh/specifikimi apo çdo pretendimi tjetër.

III.2.5 Komisioni i Prokurimit Publik, thekson dallimin e qartë në gjykimin e tij, ndërmjet një pretendimi të një operatori ekonomik që ngre shqetësim mbi vlerësimin hipotetikisht të gabuar të ofertës së vetë atij nga ana e autoritetit kontraktor, nga njëra anë, dhe pretendimit/prendimeve

të këtij operatori apo të cilitdo operatori pjesmarrës në një procedurë prokurimi publik ndaj mënyrës së vlerësimit të autoritetit kontraktor për operatorët e tjerë konkurrentë në këtë procedurë, nga ana tjetër, apo çdo pretendimi tjetër. Në rastin e parë, kur interesi është absolut dhe i drejtpërdrejtë, barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit, ndonëse sërish qëndron mbi ankimesin, në gjykimin e KPP është arsyeshmërisht më e lehtë. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit, dhe në kuptim të misionit të tij për të siguruar efikasitetin e procedurave të prokurimit publik, përmes nxitjes së pjesmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson se duhet të adoptojë një qëndrim proaktiv, në krah të operatorit ankimes. Në rastin e dytë, kur operatori pjesmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi kurrizin e pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion re-aktiv, në pritje të argumenteve të plota provuese, se përse vlerësimi i autoritetit kontraktor ka qenë i gabuar, sipas ankimesit, dhe përse kërkon anulimin e tij duke e argumentuar me prova në këtë ankesë.

III.2.6. Një pretendim pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi një specifikim apo kriter në përmbushje të konkurrentit/konkurrentëve të kualifikuar përpara tij, apo çdo pretendimi tjetër do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cënon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP pasi janë pretendime të cilat nuk mbështeteten në asnjë argument, por vetëm mbi pretendim hipotetik e dyshime të paarsyeshme.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes “Studio Services D-S” SHPK nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimesi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të mos pranohet ankesën e operatorit ekonomik “Studio Services D-S” SHPK për procedurën e prokurimit “Shërbim konsulence”, me nr. REF-27371-05-04-2022 me

objekt “Hartim projekti rehabilitimi rrugës “Kasem Durrësi” me fond limit 2,472,686.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 20-05-2022 nga autoriteti kontraktor Bashkia Durrës.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Studio Services D-S” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

